


Ekskluzivisht për www.pashtriku.org



A D E M G U T A
E K Z E M P L A R I I P A T R I O T I Z M I T
T Ë G J E N E R A T Ë S (1 9 1 6 - 1 9 4 5)

P R O F . D R . M U H A M E T P I R R A K U

(Rezymeja e veprës e cila del nga shtypi më 5 nëntor 2008)

- *“Më njih në vepër, sepse njeriu nuk është emri, por është*

vepra e tij! Adem Demaçi

Veprimtari i çështjes shqiptare, i dalluar në gjeneratën e tij, *Adem Guta*, e ka prejardhjen atërore malësore nga fshati *Jezerc* i *Ferizajt*. I et i Tij, *Xheladin Latifi*, i shtrënguar nga varfëria, që në rini u punësua rrogëtar e çifçinj ndër familjet e kame të rrethinës së *Ferizajt*. *Adem Guta* u lind në *Nikudim* në pjesën e parë të vitit 1916. Kjo është koha e robërisë së egër bullgare. Në mungesë të ushqimit, *Ademit*, së pari i vdiq e ëma, *Zethanja*, kurse dy javë më vonë edhe babai. Këto vdekje ndodhën nga fundi i vitit 1916 ose në pjesën e parë të vitit 1917, në *Nikudim*, duke lënë jetim tre fëmijët: *Hanumshahin* rreth 17 vjeçare, e sapo martuar, *Vejselin* në moshën 10/11 vjeç dhe *Ademin* nën moshën një vjeç. Dy jetimët mbeten midis të katër rrugëve pa pasur asnjë të mirë materiale për jetë, as kulm mbi kokë. Fillimisht, për ekzistencën elementare të tyre, për jetën e tyre, do të kujdesën dajallarët, kurse nga fillimi i viteve të '20-ta *Ukë Latifi*, xhaxhai, i cili jetonte në *Ilirias* (ish-Zaskok).

Hapin e parë për t'i vu nipat në hullinë për të ardhmen me dinjitet, *Uka* e bëri duke e kthyer *Vejselin* në “*Mejtepin e Mulla Shefki Pleshinës*”. Pas mbarimit të mejtepit në vitin shkollor 1924/25, *Vejseli*, tashti rreth 20 vjeç, shkoi në Prizren dhe u regjistrua në “*Medresenë e Lartë të Mehmet Pashës*”. I vëllai i *Vejselit*, *Ademi*, për sa i përket jetës fëmijërore dhe shkollimit, pati një fat shumë më të keq se të vëllait. Sa vinte e kujdestarit të tij i keqësohej baza ekonomike, ndaj nuk kishte mundësi reale që *Ademin*, dhe djemtë e tij, t'i dërgonte në shkollën në gjuhën serbe, e as në mejtep.

Së këndejmi, *Ademi* shumë herët do të përballet me tmerret për të mbijetuar nga uria. Pa i bërë dhjetë vjet jetë u punësua rrogëtar - bari delesh për kafshatë goje tek një serb nga Zaskoku. Nga kjo fatkeqësi, megjithatë, doli një e mirë. Kontakti i vazhdueshëm dhe intensiv me moshatarët serbë, e me serbë të rritur, hapi shteg që fëmija shqiptar bonjak të mësonte gjuhën serbe si dhe shkrim-leximin me shkronja cirilike. Interesimin e madh të *Ademit* për shkollim e përcillte me kujdes i vëllai i tij, medresanti *Vejsel Guta*, ndaj sapo ky i mbaroi klasat e ulëta të medresesë, meqë ishte *talebja* më i dalluar në mësim, do të angazhohet në mësimdhënie në klasat e ulëta të medresesë, me një shpërblim simbolik. Njëkohësisht do të punësohet hoxhë ramazani në fshatin *Zotaj* (ish-Vojnoc) të Shtimes. Kjo, *Mulla Vejselit*, i krijoi pak kushte për martesë dhe për ta marrë *Ademin* pranë vetës, duke e

regjistruar në shkollën fillore në Prizren.

Nisur nga të dhënat për vitin e mbarimit të klasës së IV-të të fillores në *Državna narodna škola - "Leviška"*, *Adem Guta* klasën e parë duhej ta kishte regjistruar në vitin shkollor 1931/32, kurse klasën e katërt e mbaroi në vitin shkollor 1934/35, me *suksese të shkëlqyeshëm*. Të njëmbëdhjetë notat, në njëmbëdhjetë lëndët e mësimimit, i pati 5-she. Nuk pati asnjë mungesë në mësim gjatë tërë vitit dhe pati notë 5-she në sjellje.

Gjatë shkollimit në fillore dhe më vonë, në medrese, *Adem Guta* për mbiemër e ka pasur emrin e katragjyshit, të *Hysenit*, por në variantin e serbizuar - *Husejnoviq*, kurse për vend të lindjes në dëftesën e klasës së katërt i qëndron emri i fshatit "*Zaskok*", e për datë të lindjes *12 tetori 1922*. Del se Ademi ishte i regjistruar në amzën e të lindurve sa po i ishin krijuar mundësitë për shkollim, rreth shtatë vjet më i ri. Mirëpo, edhe kjo e keqe pati një të mirë të madhe. Si nxënës i pjekur në moshë, në fillore dhe në shkollë të mesme, bëri që Ademi të dominojë me pjekuri e rezonim shoqëror dhe politik midis bashkënxënësve.

Pas mbarimit të shkollës fillore nxënësi *Adem Guta*, ndonëse i mbytur në varfëri tepër të skajshme, pa babë, pa nënë, pa plëng e pa çati, gjithsesi i mbështetur në ndihmën financiare të të vëllait, *Vejselit*, ia mësyni "*Medresesë së Madhe të Kral Aleksandrit I*" në Shkup. Ishte viti shkollor 1935/36, gjenerata e *Njëmbëdhjetë*. Moshë e pjekur ndikoi që të shikohej si autoritet midis bashkënxënësve. Mirëpo, pa vonuar *Adem Guta* krahas mësimimit do të detyrohej të merrej me punë krahu, për të siguruar ekzistencën personale dhe të familjes së të vëllait, *Mulla Vejselit*, i cili u mor në shërbimin ushtarak.

Sot nuk kemi informata administrative se në çfarë shkalle *Ademi* i ndoq mësimet, sa ishte i rregullt, sa mungoi me arsye e sa pa arsye. Dihet vetëm se e ka humbur vitin, por iu lejua përsëritja e klasës në vitin shkollor 1936/37, gjenerata e *Dymbëdhjetë*. Mirëpo, *Adem Guta* nuk arriti të siguronte stipendi, ndaj i përballur me skamje të skajshme, duke u marrë me punë krahu, bëri shumë mungesa në mësim, ndaj nuk arriti suksese në mësim dhe e humbi vitin, së këndejmi edhe të drejtën për të qenë nxënës i "*Medresesë së Madhe të Kral Aleksandrit I*".

Mirëpo, duhet të përkujtojmë faktin se, ndonëse *Adem Guta* e humbi vitin e parë dy vjet rresht, bënte pjesë në lagjen e nxënësve më me autoritet midis nxënësve të moshuar të klasave të katërta e të treta të "*Medresesë së Madhe*". Nga pranvera e vitit 1937, i ishte bashkuar "*Organizatës së Rinisë Përparimtare Kombëtare - 'Drita'*", me seli në

Drenicë, e cila realisht drejtohej nga nxënësit e *Medresesë së Madhe të Kral Aleksandrit*, të tubuar rreth *Idriz Ajet Gashit*. *Adem Guta* nga tashti do të shquhet me aktivitet politik kombëtar ilegal dhe me shpërndarjen e librit shqip midis nxënësve të *Medreseve* e të *Shkollës Normale* në Shkup dhe midis rinisë së Ferizajt.

Bashkënxënësi i *Adem Gutës*, shkrimtari dhe publicisti *Vehap Shita*, midis të tjerave, do të konstatojë: “*Adem Guta ishte më i mocëm se unë, për disa vjet, mjaft i pashëm(...), shumë i ndershëm, shumë temeli, njeri i pastër, i matur, i fjalës. Të imponohej me qëndrimin e vet(...). Kurrë nuk ishte përkrahës i Lëvizjes Komuniste, nuk ishte ‘Skoj’, siç ishin shumica e nxënësve të ‘Medresesë së Madhe’.* Ademi prej fillimit ka qenë në anën e atyre që janë përpjekur për çështjen nacionale, për çështjen shqiptare...”

Ndonëse humbja e vitit ishte një goditje e rëndë, *Adem Guta* e dinte pozitën e tij sociale dhe për mospësuksin kishte arsye të forta të mos demoralizohej. Pas kthimit nga shërbimi ushtarak të *Mulla Vejselit*, Ademi tashti do t’ia mësyjë “*Medresesë së Gazi Isa Beut*” në Shkup. Në përmbyllje të *Lutjes* saktësonte: “...shihet se e kam dhënë provimin pranues në *Medresenë e Madhe të Kral Aleksandrit* (viti shkollor dhe në *Medresenë e Gazi Isa Begut* në Shkup.

Në bazë të të dhënave statistikore të *Drejtorisë së “Medresesë Qendrore të Reformuar “Gazi Isa Beg”* për regjistrim në vitin e parë të vitit shkollor 1937/38, kandidatët u provuan në lëndët: *Gjuhë serbokroate* dhe *Matematikë*. *Adem Guta*, alias *Hysejnoviq Adem* në provimin me shkrim nga *Gjuha serbokroate* u notua me notën (5), kurse me gojë mori notë (4). Nga matematika u notua me (4).

Dhënia e provimit pranues me një rezultat të tillë i hapi rrugë për sigurimin e bazës materiale për shkollim me shpenzime të *Vakëfit të Bashkësisë Islame për Viset Jugore*, me Seli në Shkup. Në “*Medresenë e Isa Begut*” talebja *Adem Guta* do të dëshmojë kualitete të larta intelektuale dhe njerëzore. Klasa e parë e vitit shkollor 1937/38 i përkiste gjeneratës së dytë të “*Medresesë së Reformuar Qendrore - Gazi Isa Beg*”.

Vërtet, nxënësi *Adem Guta*, me moshë djaloshare të pjekur, në klasën e parë të “*Medresesë Isa Beg*” u tregua i zoti, me dinjitet të madh dhe klasën e parë e kreu me sukses shumë të mira. Në klasën e dytë të vitit shkollor 1938/39, *Adem Guta* sa vinte dhe bëhej edhe më i dinjitetshëm, nxënës i pjekur në moshë dhe me individualitet të theksuar. Tashti, përpos lidhjeve me nxënësit e klasave të larta të “*Medresesë së*

Madhe”, që u përmendën më herët, mbante kontakte të afërta edhe me nxënësit e dalluar të “*Shkollës Normale*” të Shkupit, si me *Jahja Fushën*, të *Besianës*, e të tjerë si dhe me *Konsullatën e Shqipërisë* në Shkup, ku merrte literaturë propagandistike kombëtare dhe udhëzime politike për veprim midis bashkënxënësve dhe masave shqiptare. Bashkënxënësi i tij, *Sinan Hasani* në librin “*Në fokus të ngjarjeve...*” (më 2005), midis të tjerash, do të konstatojë: “...*Me një rreth të ngushtë, të shokëve të shkollës, Adem Guta na foli për porosinë e konsullit shqiptar në Shkup, që të zhvillojmë unitetin nacional ndër vete dhe të kultivojmë patriotizmin dhe dashurinë ndaj nënës Shqipëri. Ndaj kërcënimeve italiane (ndaj Shqipërisë-M.P), thoshte ai, duhet të kemi qëndrim burrëror(...)*”.

Vërtet, sa vinte dhe *Adem Guta* depërtonte sa më fuqimisht në qarkun e bashkëveprimtarëve arsimorë, kulturorë dhe politikë të *Mulla Vejsel Gutës* në mbarë Kosovën, qark ky i përbërë nga personalitetet e lidhura fuqimisht me masat popullore, të dëshmuara në përpjekjet për ruajtjen e substancës shqiptare të Kosovës para dhunës shkombëtarizuese serbe të *Mbretërisë Jugosllave*. Në vitin 1938, i vëllai, *Mulla Vejsel Guta* mualim dhe poet i shquar në gjuhën shqipe e solli familjen në fshatin *Zotaj*, i mbështetur në kryefamiljarin e autoritetshëm, *Ramadan Sylejman Mehmetin*, arsimdashës dhe patriot i guximshëm. *Adem Guta* nga tashti pushimet verore dhe të festave të ndryshme, vetë dhe me shokët, do t’i kalojë në gjirin e familjes së vëllait, ndaj fshatarët e *Zotajve* edhe *Adem Gutën* do ta konsiderojnë si bashkëfshatarë të tyre shumë të respektuar. Nga tashti, *Adem Guta*, shumë aktivitete kulturore e politike do t’i lidhë me “*Mejtepin e Mulla Vejselit*” në *Zotaj*, i cili shërbente si një klub ilegal i “*Komitetit të Kosovës*” së *Bedri be Pejanit*.

Ndonëse *Adem Guta* do të merret me veprimtari politike ilegale kombëtar të dëndur, *klasën e dytë* e kreu, prapë, me sukses *Shumë të mirë*. Në vitin shkollor 1939/40 Ademi i ndoqi mësimet e klasës së tretë. Tashti, në jehonën e *Luftës së Dytë Botërore*, kur priteshin ndryshime edhe për fatin e kombit shqiptar të copëtuar, *Adem Guta* edhe më shumë iu dha aktiviteteve politike kombëtare, duke i lënë mësimet më anash, ndaj *klasën e tretë* e kreu me sukses *të mirë*. Klasën e katërt të “*Medresesë së Gazi Isa Begut*”, *Adem Guta* e ndoqi gjatë vitit shkollor 1940/41.

Publicisti *Shemsi Mehmeti*, bashkënxënës i *Adem Gutës*, midis të tjerash, do të konstatojë: *Adem Guta ishte “shumë më i madh dhe më i pjekur se të gjithë ne në klasë, personalitet që ishte i kyçur në rrjedhat*

shoqërore e politike. Ne, një pjesë nga bashkënxënësit, nuk dinim asgjë për vetën tonë shqiptare, ose fare pak dinim.

Ndërkaq Adem Guta shpesh i trajtonte çështjet kombëtare, e përmendte rëndësinë e gjuhës shqipe, fliste për të drejtat kombëtare shqiptare, e sa më kujtohej, na fliste edhe për Flamurin kombëtar. Në shkollë, në prani të profesorëve, e kishim të ndaluar të flisnim shqip edhe njëri nxënës me tjetrin...”

Të dhënat burimore për sukseset përfundimtare në vitin shkollor 1940/41, na mungojnë për të gjithë nxënësit, pasi sulmi nazifashist mbi Jugosllavinë Versajase u krye në fillim të prillit 1941 dhe shkolla e ndërpreu punën. Bashkënxënësit e Tij pohojnë se Adem Guta ishte nxënës i mirë në mësim edhe gjatë atij viti shkollor, se ishte shumë i respektuar nga bashkënxënësit dhe shumë aktiv në çështjen kombëtare shqiptare. Nga një procesverbal, i padatur, por të cilin e konsiderojmë se është i para prillit 1941, gjejmë se nxënësi Huseinoviç ishte i notuar, nuk kishte nota të dobëta dhe se edhe klasën e katërtë do ta përfundonte me sukses të mirë.

Para se të merrte fund ndarja e zonave të interesit midis aleatëve nazifashiste në Kosovë, Adem Gutën e gjejmë në Llap, pranë Mulla Hysen Statovcit, Hoxhë Visokës e Jahja Fushës, duke kryer aktivitet politik në dobi të kërkesës shqiptare për moslënien e Llapit në kuadër të Serbisë së Nediqit. Në vjeshtën e vitit 1941 edhe në Llap u hapën shkollat e parë shqipe, kurse Adem Gutën e gjejmë mësues në Besianë, seli kjo e Nënprefekturës së Llapit. Shumë nxënës të Shkollës “Skënderbeg” Mësuesin Adem e kujtojnë me respekt të madh.

Meqë Adem Guta kishte një moshë të pjekur, rreth 25 vjeçar, dhe ishte i njohur me veprimtari politike kombëtare në muajin shkurt 1942 do të emërohet kryetar komune në Vaganesh të Dardanës (Morava e Poshtme). Meqë Adem Guta do të tregohet i pa kompromis në luftën politike kundër propagandës antifashiste kominterniste jugosllave, me ndërhyrjen e komunistëve shqiptarë të infiltruar në mbarë administratën e Nënprefekturës së Gjilanit, pas rreth dy muajve në shërbim si kryetar komune në Vaganesh, do të transferohet kryetar komune në Qëndresë (ish-Sllatina e Epërme) të Moravës së Epërme.

Kryetari i parë i komunës së Qëndresës në periudhën e “Mbretnisë Shqiptare” nën kurorën e Romës, ishte Adem Imeri nga Qëndresa, personalitet me autoritet, por pa shkollë të mjaftueshme, kurse sekretar i komunës ishte Muhabi Nuhiu, vendës ish-medresant i klasës së pestë të “Medresesë Gazi Isa Beg”. Ardhja e Adem Gutës për kryetar

komune në *Qëndresë* solli ndryshime edhe në administratën e komunës. Për sekretar komune *Adem Guta* solli me vete ferizajasin *Engjëll Gjini*. Shkakun pse nuk e mbajti *Muhabiun* për sekretar ishte fakti se Ai i kishte afri të ngushtë me komunistët: *Ramadan Agushi, Sinan Hasani, Shinasi Hallaçi* etj.

Patrioti zemërluan, *Adem Guta*, i njihte këta si *skojistë* qysh në kohën e shkollimit në Shkup, ndaj i mbajti shumë larg vetës, i vetëdijsëm se aktiviteti i tyre në shërbim të *Lëvizjes Antifashiste Nacionalçlirimtare Jugosllave* ishte i pakontrollueshëm veçanërisht për faktin se mbështeteshin në krerë të lagjes së *Musli Pirës, Kurtesh Agushit, Ramiz Cërnics* e të *Hysen Tërpezës*, dy të fundit kryetar komunash, me ndikim në masat fshatare, të cilët kishin lidhje politike prokomuniste e afri miqësore me bartësit e *Lëvizjes Antifashiste Nacionalçlirimtare Jugosllave*, serbë e shqiptarë, në Anamoravë. Ndaj *Adem Guta* e thoshte botërisht: *Me komunistët e çetnikët serbë e kam lehtë, por nga bashkëpunëtorët e tyre shqiptarë nuk mund ta sigurojë qetësinë dhe ardhmërinë e shqiptarisë së vendit...!*

Patrioti *Adem Guta*, ishte i guximshëm, shumë i përkushtuar ndaj çështjes kombëtare dhe kishte besim të pafund në vetën. I pashëm, njeri me orë - i rrallë si Ai. Kishte besim në shkathtësitë e tija dhe në armët e tija. Realisht, të tërë aktivitetin administrativ dhe politik *Adem Guta* do ta zhvillojë në rrethana të luftës, ngase në viset e komunës së *Qëndresës* dhe në komunat fqinje vepronin baza të hershme të *Lëvizjes Antifashiste Komuniste Jugosllave* dhe të *Lëvizjes Çetnike Serbe*. Në vise të Moravës ndihej rreziku i vazhdueshëm i terrorit të okupatorit bullgar që zbatohet në viset shqiptare në lindje të lumit *Moravë*. Së këndejmi, *Adem Guta* ishte i detyruar të kultivonte vigjilencën në popull për organizimin e sigurisë dhe të mbrojtjes shqiptare vullnetare në fshatrat që i administronte komuna.

Nga fundi i vitit 1942, krahas përkushtimit kundër propagandës komuniste jugosllave antishqiptare, kryetari *Adem Guta* do t'i kushtojë kujdes të madhe edhe spastrimit të mbiemrave të popullsisë shqiptare nga prapashtesat “iç” e “viç” të cilat i futi me dhunë administrata e *Jugosllavisë Versajase*, kurse nga marsi i vitit 1943, do t'i shtrohet kërkesës zyrtare legale për rishqyrtimin dhe standardizimin shqip të korpusit onomastik të Kosovës. I vendosur për t'u bërë kurban i *Shqipërisë Natyrore*, vazhdonte të ishte njëri ndër kryetarët e komunave që edhe natën e kthente në ditë pune për të siguruar mirëqenien e banorëve dhe të ardhmen shqiptare të patrazuar të *Moravës së Epërme*.

Nga fundi i majit të vitit 1943, kryetari i komunës së Qëndresës, *Adem Guta*, arriti të kurorëzojë një sukses të madh të përpjekjeve të gjata për çlirimin nga pushtuesi bullgar të viseve shqiptare të *Moravës së Epërme* në lindje të lumit “*Moravë*”. Këso kohe *Komunës së Qëndresës*, do t’i bashkëngjiten pesë fshatra, të cilat u administruan barbarisht nga “*Bullgaria e Madhe*” që nga prilli i vitit 1941. Si rrjedhojë e parë pozitive e kësaj ngjarje për shqiptarësinë e fshatrave të sa po ribashkuara me komunën e *Qëndresës*, ishte fillimi i punës së shkollës shqipe në *Urban* (ish-Vërbani), më 1 qershor 1943.

Propaganda komuniste, në një anë dhe ajo çetnike në anën tjetër, ndonëse me programe të ndryshme politike sa i përket pushtuesit nazifashist, ishin të bashkuar në një qëllim të vetëm: Të luftonin përpjekjet e *Adem Gutës* që viset e komunës ku ai qeveriste t’i mbante si bastion të *Mbrojtjes Kombëtare Shqiptare për Anamoravën*. Ndaj, në fillim të gushtit të vitit 1943, kryetari *Adem Guta* u detyrua të merrte një hap vendimtar për të çrrënjësuar propagandën serbe antishqiptare në viset e komunës ku ai administronte. Sipas raporteve të *ushtrisë italiane* në *Ferizaj* dhe *Gjilan*, më 6 dhe 10 gusht 1943, *Adem Guta* me vullnetarët dhe xhandarmërinë komunale arrestoi 215 çetnikë dhe komunistë serbë. Ndaj atyre që iu kapën materiale komprometuese antishqiptare u përdorë dhuna fizike, por pati edhe të ekzekutuar. Si rrjedhim, pasoi burgosja nga ushtarët italianë e kryetarit *Adem Guta*, si përgjegjës për ndodhjen.

Kurbani i shqiptarisë, *Adem Guta* do të dërgohet në Burgun e Prizrenit, ku do të qëndrojë deri rreth datës 11 shtator 1943, kur, pas kapitullimit të Italisë Fashiste para armëve të aleatit nazist, *Këshilli i Ministrave të Mbretërisë së Shqipërisë* nën kryesinë e *Iljaz Agushit*, shpalli njëanshëm neutralitetin e shtetit dhe të kombit shqiptar ndaj *Gjermanisë Hitleriane*.

Nga himnizimi poetik “*Adem, ore Vlla*” i *Mulla Vejselit*, del se *Adem Guta* pas lirimimit nga burgu, shkoi kryetar komune në *Anadrini*, por e la postin shpejt dhe shkoi mësues në *Besianë të Llapit*, ku i kishte edhe shokët më të ngushtë, disa bashkënxënës dhe shumë bashkëveprimtarë politikë. Të dhënat e verifikuara mirë tregojnë se *Adem Guta* në vitin shkollor 1943/44 dha mësim në *klasën e dytë*, lexonte shtypin legal dhe ilegal, mbante qëndrim të rezervuar me mësues e nëpunës. Tashti kishte shumë të dhëna për faktin se komunistët e linjës së PKJ-së kishin depërtuar në qarqet shkollore dhe administrative shqiptare në të gjitha nivelet, se shumë kryetar komunash, krerë që i nderonte populli, koketonin dhe bashkëpunonin me të ashtuquajturën “*Lëvizje Nacional-*

çlirimtare Komuniste Jugosllave” dhe se tashti, të gjitha parametrat politik tregonin se fitorja e *Bllokut Botëror Kundër-nazifashist*, së këndejmi edhe e *komunistëve kominternistë jugosllavë*, ishte realitet që pritej të ndodhte.

Pranvera e vitit 1944 shkoi me luftëra të përgjakshme të *Mbrojtjes Kombëtare Shqiptare* në kufirin serbo-malazias. Aktiviteti politik i *Adem Gutës* në kuadër të *Programit të Mbrojtjes Kombëtare të Kosovës*, zhvillohej përkrah të vëllait, *Mulla Vejselit*, veprimtar i *Komitetit të Lidhjes së Dytë të Prizrenit për Nënprefekturën e Ferizajt*, kurse nga maji i vitit 1944 *Adem Guta* mund të konsiderohet edhe veprimtar i “*Lëvizjes së Ballit Kombëtar*”. Me dorën e tij e shkroi një informatë të shkurtër ku fliste për shkallën e gatishmërisë së banorëve të fshatit *Zotaj* për t’u hedhur në *Mbrojtjen Kombëtare të Kosovës* nën ombrellën organizuese të “*Ballit Kombëtar*”. Shkroi: “*Unë i qujtuni Adem Guta nga Jezerci banues në katundin Vojnovc komuna e Neredimjës sod me datën 21 maj 1944 kam qenë në Vojnovc kurse në bisedimin e banun më popullin e k’ij katundi të gjithë e pranojnë drejtimin e Ballit Kombëtar. AGuta*”.

Pas mbarimit të vitit shkollor 1943/44, nga gjysma e qershorit 1944, *Adem Guta* u kthye në gjirin e familjes së të vëllait, *Mulla Vejselit* në *Zotaj*. Këtu *Adem Guta* do ta përjetojë një ambient të përkushtuar përpjekjeve për *Lirinë e përvetshme të Kosovës*. Meqë “*Mejtepi i Mulla Vejselit*” vazhdonte të ishte një si *Zyrë përfaqësuese e Komitetit të Lidhjes së Dytë të Prizrenit për Nënprefekturën e Ferizajt*, patrioti *Adem Guta* do të lidhet forcërisht me shumë burra të përkushtuar luftës për ruajtjen e tërësisë së Shqipërisë.

Nga fundi i korrikut të vitit 1944, *Adem Guta* iu bashkua myderrizit *Mulla Vejsel Guta* për përgatitjen e njësitit të vullnetarëve nga radhët e talebeve të rritur të *Medresesë së Mulla Vejselit* për frontin në viset kufitare të Kosovës *Lindore - Bujanoc - Preshevë*. Formësimi ushtarak i *Njësitit luftarak të Medresantëve*, u realizua në fillim të gushtit 1944, para *Komitetit të Lidhjes së Prizrenit për Nënprefekturën e Ferizajt* dhe kishte dy komandant përgjegjës: *Mulla Vejselin për moral luftarak dhe kreun Ramadan Sylë Mehmetin* - përgjegjës për strategji luftarake. Njësitin e pritën veprimtarët e *Komitetit të Lidhjes*: tregtari *Aziz Ramadan Mehmeti-Vojnovci* dhe *Selman Abdyl Muhoci*, të shoqëruar nga veprimtari politik, *Adem Xheladin Guta*.

Nga fundi i tetorit dhe fillimi i nëntorit 1944, propaganda komuniste serbe e shqiptare kreu një aktivitet të madh në përvetësimin e krerëve,

intelektualëve, e ushtarakëve të Kosovës për t'i tërhequr vullnetarët dhe ushtarët nga kufijtë e Shqipërisë Etnike në përkufizim me malazezët, serbët e bullgarët. Sa dimë deri tashti, në viset e *Kosovës Lindore* vetëm kryetari i komunës së *Pozheranit*, Hysen Tërpeza, e korrigjoi vetën me një kthesë vendimtare dhe iu kthye *Mbrojtjes Kombëtare të Kosovës*. Ai, në javën e parë të nëntorit 1944, e ftoi një takim të krerëve të *Moravës së Epërme* në *Pozheran*, në të cilin e gjejmë pjesëmarrës edhe ballistin ferizajas, *Adem Gutën*. Nga fjala e *Hysen Tërpezës* shihet se Ai po fliste edhe në emër të shumë bashkëvendimtarëve, deri dje përkrahës të “*Nacionalçlirimtarës Antifashiste Komuniste...*”, e tashti të vendosur për të mbrojtur *Lirinë* dhe tërësinë e *Shqipërisë Etnike*.

Mirëpo, në rrethanat që do të krijohen gjatë pjesës së dytë të nëntorit 1944, kur në Kosovë arritën edhe disa brigada partizane shqiptare, edhe *Adem Guta*, me shumë veteranë të *Mbrojtjes Kombëtare të Kosovës*, do të rreshtohet në radhët e njësive partizane, pikërisht në “*Brigadën VII Sulmuese të Kosovës e Metohisë*”, e themeluar në *Gjakovë* më 11 nëntor 1944. Komandant i kësaj brigade ishte *Shaban Haxhia* - “*Përzha*” nga *Malësia e Tropojës*, komisar *Qamil Brovinën*, nga *Gjakova*, kurse nënkomesar serbi *Çedo Mishkoviq*. *Brigada VII Sulmuese e Kosovës-Metohisë*, alias e *Shaban Haxhisë*, së cilës, nga pjesa e dytë e janarit të vitit 1945, duhej t'i bashkohej edhe pjesa partizane e mobilizuar nga *Shaban Palluzha*, në *Drenicë* e rrethinë. Të dhënat e vjella me kujdes flasin se *Adem Guta* hyri në radhët e ushtrisë partizane sapo njësitë e *Brigadës së VII* arritën në vise të Shtimes më së voni deri nga fundi i nëntorit 1944, i radhitur pikërisht në *Kompaninë e Tretë të Batalionit të Parë*. Komandant i *Batalionit I* ishte kapiteni *Ethem Stublla*, komisar ishte një serb, kurse Komandant i *Kompanisë së Tretë* ishte togeri *Abdullah Hoxha*. Kjo kompani u vu në lëvizje për në *Frontin e Sremit*, më 19 janar 1945, kurse më 20 janar njësia e la *Besianën* dhe gjithnjë këmbë arriti në *Kurshumli*. Aty, më 21 nëntor 1945, u ngarkua në tren deri në *Smederevë*, e prej nga me anije, *Danubit* të lartë, gjatë natës së 21/22 janar 1945 arriti në afërsi të *Kikindës*. Sipas kujtesës historike që e ka ruajtur populli, *Adem Guta* në nisje e sipër, më 19 janar 1945, publikisht i qortoi dhe i ftoi shokët e rekrutuar ushtarë se: “*Nënat na kanë lindur për ta mbrojtur Kosovën e jo Serbinë...!*”

Revolta e *Eshalonit të Shaban Palluzhës*, më 21 janar 1945, pati jehonë në rritjen e pakënaqësisë në radhët e efektiveve të *Brigadës VII të Kosmetit* gjatë ditëve të para të fushimit e të trajnimit për luftë në vise të *Kikindës* dhe të *Vërshacit*. Njëri midis më të zëshmeve kundër lënies së

Kosovës në duart e ushtrisë serbe, bullgare, maqedone e malazeze ishte, pa dyshim, patrioti i përkushtuar lirisë së kombit shqiptar, *Adem Guta*. Revoltimin e *Adem Gutës* nuk arriti ta zbuste asnjë këshillë e bashkëushtarve. Ndjehej i zhgënjyer në vetën pse kishte pranuar t'u bashkohej forcave partizane, të cilave kurrë nuk u kishte besuar.

Analiza e hollësishme e informatave tregon se *Adem Guta* ishte arrestuar në tradhti dhe pa prani të bashkëushtarëve, ishte mbajtur i izoluar në burg rreth dhjetë ditë dhe më 2 shkurt 1945, pasi iu shqiptua aktakuza si dhunues e vrasës i serbëve në periudhën e kryetarllëkut në komunën e Qëndresës, dhe për propagandë kundër vëllazërim-bashkimit shqiptaro-serb, do të pushkatohet në *Mramorak*, afër *Kovinit*, në Vojvodinë. Ekzekutimi ishte tepër sadist. Para rreshtit të qindra ushtarëve vrojtues, në *Adem Gutën* shtiu një skuadër prej dhjetë vetave, kryesisht komunistë e skojistë që vinin nga Gjakova e rrethina.

Nga shumë të dhëna të verifikuara mirë dihet se akuzuesi kryesor kundër *Adem Gutës* ishte komisar i *Batalionit III*, *Nazmi Kursani*. Ndërkaq, *Kurbani i shqiptarisë së Kosovës*, *Adem Guta*, në minutat e fundit të jetës së tij, para skuadrës së ekzekutorëve, u tregua shumë trim, e shumë dinjitoz. Ecte para tytave të ushtarëve që e sillnin, në vendin e pushkatimit publik, me krenari të papushtueshme. Kundërshtoi t'ia mbulonin fytyrën dhe sapo e lidhen për një peme, arriti ta kthente kokën kah ushtarët me gjak të mpirë në fytyrë dhe u thërriti: “*O burra, bonmani hallall...!*”

Hulumtimi i fakteve dhe analiza e situatës së sigurisë të jetës së bashkushtarëve të *Adem Gutës* tregojnë se asnjë person, i pranishëm, nuk rrezikoi të kundërshtonte kundër pushkatimit të *Adem Gutës*, për faktin se shumica absolute e “*ushtarëve*” dhe një pjesë e eprorëve të *Lagjes së Avdyl Dyrës*, *Ejup Binakut* e të *Rrustem Statovcit*, etj, që ishin vrojtues të krimit, ishin ish-pjesëmarrës në *Mbrojtjen Kombëtare të Kosovës*, të etiketuar nga komunistët si “*Ballistë*”, një pjesë e mirë nga të rinjtë, ishin të bijtë e atyre që kishin marrë pjesë në *Mbrojtjen Kombëtare të Kosovës*, ose ishin pasardhës të afërt ose të largët të personave që tashti më ishin hedhur në *Luftën e Kosovës* nën drejtimin nominal të *Shaban Palluzhës*. Kishte midis spektatorëve të dhunshëm edhe bijë të të pushkatuarve ose të të burgosurve në burgjet e *OZN*-ës.

Cerberët e ruajtjes së Vëllazërim-bashkimit të shqiptarëve me serbët albanofobë, komunistët shqiptarë, Kurbanit të Shqipërisë Etnike, *Adem Gutës*, ia humbën edhe varrin, kurse emrin e veprën e Tij e kualifikuan si *tabutemë* të dënueshme për atë që do të merrte guxim ta evokonte

kujtimin për veprën kombëtare shqiptare dhe për rënien e tij heroike, për tërësinë dhe lirinë e Shqipërisë Etnike.

Dhe, sikur të fliste i martirizuari për *Atdhe*, do t'u thërriste brezave sot e nesër me porosinë që e artikuloi madhori i kombit shqiptar, *Adem Demaçi*: “*Më njih në vepër, sepse njeriu nuk është emri, por është vepra e tij!*”

* * *



Adem Guta 1935



Klasa e parë e Medresesë së Madhe, viti shkollor 1935/36, me kujdestarin e klasës, Fuad Slipçeviq. Adem Guta i pesti në mes, më i larti në rreshtin e tretë, në këmbë.




Nga e majta lartë (rreshti i tretë), i treti në këmbë Adem Guta me xhamadan dhe terlemen e bardhë mbi kokë. Para tij: Myderriz Hasan Efendi Islami-Nahi. Në rreshtin e parë(ulur), me këmishë e pantollana të bardhë, Vehap Shita, sapo u regjistruan në Medresenë e Madhe në Shkup.

=====



Adem Guta, nxënës në klasën e parë të Medresesë së Madhe (viti shkollor 1935/36)

=====



Mulla Vejseli